



“Vlera e Vërtetë e Parasë”

Banka e Shqipërisë, 2008

Përmbajtja


Vlera e Vërtetë e Parasë	5
Çfarë është “Vlera e Vërtetë e Parasë”?	6
Përse “Vlera e Vërtetë e Parasë”?	7
Konkursi i parë	10
Përse Banka e Shqipërisë organizon “Vlera e Vërtetë e Parasë”?	15
Pyetjet	18
Në vend të mbylljes	23



"...sinqerisht që më mungon shumë kjo puna e konkursit. Isha mësuar me atë lloj stresi (filloi të më dukej vetja pak si i rëndësishëm). Ha ha ha. Dhe mbi të gjitha më shijoi i gjithë ai diskutim mbi normat e interesit, inflacionin dhe gjëra të tjera të këtij lloji. Deri më tani kam qenë i pavendosur për sa i përket shkollës së lartë, por tashmë ekzistojnë nëntëdhjetë e nëntë për qind mundësi të shkoj për ekonomi dhe madje ka mundësi dhe masterin ta vazhdoj për banking qendror. Besoj se e kuptoni sa eksperiencë e paparë dhe e rëndësishme ka qenë kjo për mua, dhe sa ka ndikuar në të ardhmen time. Dhe për këtë ju falenderoj sinqerisht.

P.S. Këtë e-mail po e shkruaj nga laptopi që Edhe një herë FALEMINDERIT.
Elidon Gjoka. Pjesëtar i ekipit të shkollës së mesme të përgjithshme "Sami Frashëri" Tiranë, fitues i vendit të dytë në konkursin "Vlera e Vërtetë e Parasë", për vitin shkollor 2007-2008.

Vlera e Vërtetë e Parasë...



"Kjo garë përfaqëson një mënyrë shumë të mirë për të mësuar dhe për ta nxjerrë lëndën e Ekonomisë jashtë teksteve shkollore, në jetën e përditshme. Ajo ishte një përvojë e frytshme për pjesëtarët e ekipit, klasën e tyre dhe sigurisht një inkurajim, që edhe ne mësuesit e tyre, të jemi në korrent me zhvillimet dhe konceptet ekonomike."

Pranvera Pone. Mësuese e lëndës së ekonomisë, shkolla e mesme e përgjithshme, "Partizani", Tiranë.

Të dyja përshtypjet e mësipërme kanë të bëjnë me të njëjtin aktivitet, konkursin e Bankës së Shqipërisë për nxënësit që ndjekin vitin e tretë të shkollës së mesme. Ai është emërtuar "Vlera e Vërtetë e Parasë" dhe synon të njohë e të thellojë njohuritë e pjesëmarrësve mbi: objektivin kryesor të Bankës Qendrore, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe hartimin e zbatimit të politikës monetare. Konkurse të kësaj natyre organizohen nga disa prej bankave qendrore të vendeve me ekonomi të zhvilluar, por në Shqipëri ai u zhvillua për herë të parë gjatë muajve prill dhe maj, të vitit 2008. Megjithatë i pari në llojin e tij "Vlera e Vërtetë e Parasë" është konceptuar dhe organizuar sigurisht, duke u përshtatur me rastin e ekonomisë shqiptare por edhe duke u bazuar në përvojën e më të mirëve si për shembull, Banka e Anglisë, Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

ÇFARË ËSHTË “VLERA E VËRTETË E PARASË”?

Në mënyrë ideale do ta përshkruanim si një përvojë të paharrueshme, e cila kërkon një përkushtim dhe seriozitet maksimal, por ku suksesi është i arritshëm dhe argëtimi nëpërmjet edukimit është i garantuar. Praktikisht është një konkurrim prej rreth nëntëdhjetë minutash, ku skuadra nxënësish të përbëra nga tre veta u përgjigjen një sërë pyetjeve të kategorive të ndryshme. Pyetjet ndahen në:

1. Pyetje me shtjellim.
2. Pyetje rrufe.
3. Pyetje *quiz*.
4. Pyetje me plotësim termi.
5. Ushtrim.
6. Interpretim grafiku.
7. Pyetje e anasjelltë.
8. Prezantim.

PËRSE “VLERA E VËRTETË E PARASË”?

Politika monetare nuk ka të bëjë thjesht me inflacionin dhe normën e interesit. Ajo është e lidhur edhe me rritjen ekonomike, tregun e punës dhe rrjedhimisht me mirëqenien ekonomike të secilit prej nesh. Të gjitha sa u thanë më sipër lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me një objektiv të politikës monetare - Ruajtjen e një norme të ulët inflacioni - dhe me një instrument të saj - normën nominale të interesit, të vendosur prej Bankës së Shqipërisë.

Përgjithësisht, norma nominale e interesit, në çdo vend të botës vendoset nga bankat qendrore. Ajo në fjalë të thjeshta mund të quhet edhe si çmimi i parasë. Politika monetare e një banke qendrore merr vendime edhe për normat e interesit. E shprehur në mënyrë shumë të thjeshtuar kjo do të thotë se, nëse norma e interesit rritet atëherë edhe çmimi i parasë së një vendi rritet, dhe anasjelltas. Pra, siç do të lexoni edhe në shpjegimin e mëposhtëm vlera e parasë së një vendi është e lidhur ngushtë me vendimet e politikës monetare të atij vendi.

Vlera e Parasë.

Paraja e humbet vlerën e saj (atë çka ajo mund të blejë) kur çmimet në përgjithësi rriten, pra kur ka inflacion. Nëse inflacioni është i ulët, atëherë paraja e ruan vlerën e saj.

Luhatja e çmimeve.

Çmimet zakonisht pasqyrojnë nivelin e kërkesës dhe ofertës. Me fjalë të tjera, kërkesën e konsumatorëve për një mall apo produkt të caktuar, dhe mundësinë e tregut për t'i ofruar ato. Nëse kërkesa është e lartë çmimet kanë prirje të rriten, por nëse oferta është e lartë çmimet kanë tendencë të bien. Kërkesa dhe oferta mund të ndryshojnë për shumë arsye, të cilat i bëjnë çmimet individuale të rriten apo të bien.

Mbajtja e normave të ulta të inflacionit.

Nëse të gjithë njerëzit e një vendi fillojnë të shpenzojnë shumë para, në përgjithësi ndodh që çmimet në këtë vend të kenë prirje të rriten. Pra, vlera e parasë bie, me të blihen më pak mallra apo shërbime.

Në përgjithësi, bankat qendrore kanë për detyrë të ruajnë stabilitetin e çmimeve në vendet ku ato ushtrojnë aktivitetin. Kjo për arsye se çmime të qëndrueshme, do të thotë inflacion i ulët dhe rrjedhimisht, kjo do të thotë se paraja e ruan vlerën e saj. Banka e Shqipërisë e ka vendosur objektivin e saj mbi inflacionin në 3 për qind, +/- 1 pikë përqindjeje.

Çfarë bën Banka e Shqipërisë për të ruajtur vlerën e Lekut?

Banka e Shqipërisë punon që të gjithë ne të kemi besim se kartëmonedhat që përdorim janë të vërteta dhe jo të falsifikuara; të kemi besim se vlera e parasë nuk do të ndryshojë shumë shpejt ose në mënyrë të paparashikuar, pra ajo do të jetë e qëndrueshme. Ajo i arrin këto:

Duke qenë emetuesja e vetme e Lekut. Banka kujdeset që kartëmonedhat në qarkullim të jenë të konceptuara dhe disenuara në mënyrë, që të jetë shumë e vështirë për t'i kopjuar. Ajo gjithashtu, zëvendëson ato kartëmonedha të cilat janë të vjetra apo të dëmtuara, për të qenë në përdorim.

Dhe...

Duke u përpjekur të mbajë norma të ulta inflacioni, çka do të thotë se ekonomia është e shëndetshme dhe paraaja e ruan vlerën e saj.

Siç e thamë edhe më sipër Banka Qendrore e arrin këtë duke vendosur normat e interesit. Nëse çmimet në përgjithësi, fillojnë të rriten shumë shpejt në krahasim me objektivin 3 për qind +/- 1 pikë përqindjeje, Banka rrit normën e interesit me qëllim që njerëzit të shpenzojnë disi më pak dhe të kursejnë disi më shumë. Një kërkesë agregate më e ulët do të ndalonte rritjen e madhe të çmimeve, si rrjedhojë inflacioni do të ishte më i ulët.

Në rast se inflacioni ulet së tepërmi Banka ul normat e interesit, në mënyrë që njerëzit të shpenzojnë diçka më shumë.

KONKURSI I PARË

Ashtu siç u tha edhe më sipër “Vlera e Vërtetë e Parasë” u zhvillua për herë të parë gjatë muajve prill dhe maj, 2008 vetëm në qytetin e Tiranës. Pas njoftimit dhe shpërndarjes së dosjes me materialet përgatitore që Banka e Shqipërisë kreu në të gjitha shkollat e kryeqytetit, në konkurs u ftuan njëzet e shtatë shkolla. Prej tyre, vendosën të marrin pjesë njëzet shkolla të mesme, pesëmbëdhjetë prej të cilave ishin shkolla publike dhe pesë jopublike.

Në bazë të numrit të shkollave që konfirmuan pjesëmarrjen në konkurs, konkurrimi u zhvillua në tre ditë në hollin e Bankës së Shqipërisë. Gjatë 2-4 prill u zhvillua faza eliminatorë, duke u mbyllur me atë finale në 25 prill, 2008. Ditët e fazës eliminatorë u ndanë në konkurrimin e paradites dhe atë të pasdites, ku pesë ekipe, të ulura në formën e një tryeze të rrumbullakët, iu përgjigjën grupit të pyetjeve për rreth nëntëdhjetë minuta përpara panelit të jurisë, të përbërë nga drejtues të lartë Bankës Qendrore.



Indeksi i Çmimeve të Konsumit influencohet:

- Vetëm nga çmimet e mallrave të tregtueshëm;
- Vetëm nga çmimet e mallrave patregueshëm;
- Nga të dy pohimet;
- Nga asnjëri prej pohimeveve.



Përzgjedhja e rradhës së konkurrimit dhe e shkollave konkurruese u krye me anën e një shorti, të hedhur në Drejtorinë Arsimore të Tiranës.

Tre skuadrat të cilat mblodhën më shumë pikë në fazën eliminatore, konkurruan në sallën "Black Box" të "Akademisë së Arteve" të Tiranës, përpara një publiku prej dyqind vetash. Kësaj here, aktiviteti u transmetua prej Televizionit Publik Shqiptar.

PARA KONKURSI

Vetëm gjatë viteve 2007-2008 Banka e Shqipërisë ka shpërndarë rreth 18.000 broshura edukative, në 30 shkolla të mesme me 13 tituj të ndryshëm. Në këto takime punonjësit e Bankës patën rastin të njiheshin me nxënësit, të dëgjonin komentet, pyetjet dhe sugjerimet e tyre. Ishin pikërisht nxënësit që me interesin dhe komentet e tyre na bënë të mendonim se vetëm broshurat dhe takimet nuk mjaftonin.

Kështu, ishin vetë ata që na nxitën për realizimin e një aktiviteti si "Vlera e Vërtetë e Parasë"!







PËRSE BANKA E SHQIPËRISË ORGANIZON “VLERA E VËRTETË E PARASË”?

Konkursi i Bankës së Shqipërisë për shkollat e mesme u organizua për herë të parë vetëm vitin shkollor që sapo lamë pas dhe ka për qëllim, të nxisë nxënësit të mësojnë mbi rolin e Bankës së Shqipërisë në ekonominë e vendit. Megjithëse ky është një qëllim mëse i mjaftueshëm për të zhvilluar një aktivitet si ky konkurs, ka edhe dobi të tjera.

Për nxënësit, konkurrimi ofron një mundësi të mirë “për të ndezur” interesin në fushën e ekonomisë, biznesit, financës, si degë për studimet e tyre universitare apo pasuniversitare dhe pse jo, si një pedanë kërcimi drejt një karriere të suksesshme. Konkursi i Bankës së Shqipërisë i ndihmon nxënësit të fitojnë apo të përmirësojnë aftësitë e tyre në punë kërkimore, bashkëpunim, të folurit në publik dhe analizë.

Për ne në Bankë përkushtimi ndaj çështjeve të lidhura me krijimin e një kulture të mirëfilltë ekonomiko-financiare është kthyer tashmë në një traditë, për të cilën ndihemi krenarë. “Vlera e Vërtetë e Parasë” është një mundësi e mirë për ta zgjeruar këtë traditë, duke bashkëpunuar edhe me mësuesit e shkollave të mesme. Për më tepër, ky aktivitet nxit pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe kjo formë edukimi është cilësuar prej hulumtimeve shkencore, si një prej përvojave më të mira të të mësuarit. Bazuar në këto hulumtime por edhe në fuqinë e të mësuarit nëpërmjet argëtimit, Banka e Shqipërisë ka kënaqësinë të jetë sa më pranë “jetës së përditshme”, “bankave të shkollës” dhe gjithë atyre që dëshirojnë të mësojnë jo vetëm mbi ato çka shkruhen në tekstet shkollore por edhe mbi çështje ekonomike dhe financiare.

Përse nxënësit duhet të marrin pjesë në një konkurs të tillë?

- **Kuptimi më i gjerë i ekonomisë:**

Duke ofruar material mbi Bankën Qendrore, konkursi u krijon nxënësve mundësinë e një kuptimi më të mirë të koncepteve ekonomike. Gjithashtu, ata kuptojnë mënyrën se si vendimet mbi normën e interesit ndikojnë në rritjen e ekonomisë apo në arritjen e objektivit për inflacionin. Duke u njohur me rolin e Bankës Qendrore si dhe të politikës së saj monetare, nxënësit do të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike mbi këto çështje dhe mbi shfaqjen e tyre në jetën e përditshme. Pjesëmarrja në konkurs do të jetë gjithashtu, edhe një mundësi e krijimit të kontakteve me specialistë të Bankës dhe këshillimi prej tyre.

- **Materiali:**

Materiali që u shpërndahet nxënësve nga Banka e Shqipërisë është i vlefshëm edhe për të gjithë ata, që janë të interesuar të vazhdojnë studimet apo të japin mësim në fushën e ekonomisë dhe biznesit.

- **Aftësitë komunikuese:**

Përmes këtij konkursi nxënësit komunikojnë me njëri-tjetrin, me mësuesit, si dhe me specialistët e Bankës së Shqipërisë mbi çështjet dhe paqartësitë që do të hasin gjatë përgatitjes për konkurs. Atyre u kërkohet gjithashtu, që të jenë në gjendje të paraqesin një prezantim të shkurtër argumentues mbi problemet e trajtuara në material. Pjesëmarrësve kështu do t'u duhet jo vetëm që ta lexojnë me kujdes materialin, por edhe të mund të diskutojnë, si dhe të formulojnë një prezantim në lidhje me të.

- Puna në grup dhe argëtimi përmes edukimit:

Krahas njohjes së aktivitetit të Bankës Qendrore dhe ekonomisë shqiptare, konkursi u ofron nxënësve edhe mundësinë e të mësuarit dhe të punës në grup. Mirorganizimi i punës së grupit dhe mirëkuptimi i anëtarëve është shumë i rëndësishëm për suksesin e konkursit. Kështu, nxënësit duhet të punojnë së bashku si një ekip gjatë kohës së përgatitjes dhe zhvillimit të konkursit, duke u këshilluar me njëri-tjetrin gjatë dhënies së përgjigjeve edhe në rast se kanë zgjedhur vetëm njërin prej anëtarëve për t'u përfaqësuar para jurisë. Është shumë e rëndësishme që të tre pjesëtarët e grupit ta kuptojnë qëllimin e punës në ekip dhe t'i përkushtohen atij. Ata duhet të përpiqen që të nxjerrin në pah dhe të shfrytëzojnë aftësitë e secilit prej anëtarëve të ekipit, duke ndihmuar në këtë mënyrë vetë paraqitjen në konkurs. Mirëkuptimi, përkushtimi dhe transparenca brenda ekipit, janë çelësi i suksesit në këtë konkurs, i cili përbën jo vetëm një mundësi të mirë për të përfunduar njohuri, por edhe për të kaluar një përvojë argëtuese mes bashkëmoshatarësh.

Pas përfundimit të konkursit, të gjithë pjesëmarrësit janë të ftuar në një festë të organizuar për ta nga Banka e Shqipërisë.



PYETJET

1. **Pyetja me shtjellim** ka të bëjë me një nga çështjet e trajtuara në materialin përgatitor të konkursit. Përgjigjia e saj jepet me shkrim dhe koha në dispozicion për ta përgatitur atë është pesë minuta. Ndërsa koha për ta lexuar përgjigjen e shkruar është tre minuta.

Përgjigjia i dorëzohet drejtuesit të konkursit pas skadimit të afatit kohor prej pesë minutash. Ndalohet që në leximin e përgjigjes të bëhen modifikime nga teksti që ekipi ka dorëzuar paraprakisht.

Vlerësimi bëhet nga anëtarët e jurisë dhe në varësi të saktësisë së përgjigjes varion në intervalin 0-20 pikë.

2. **Pyetjet rrufe** janë pesë për çdo ekip. Përgjigjia e tyre është e shkurtër dhe duhet të jepet në harkun kohor të pesëmbëdhjetë sekondave. Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me tre pikë dhe çdo përgjigje e gabuar me minus një pikë. Në rast se përgjigjia është "nuk e di" skuadra vlerësohet me zero pikë. Vlerësimi maksimal për këtë fazë: pesëmbëdhjetë pikë.

Shembull: Çfarë është Banka e Shqipërisë dhe cilat janë funksionet e saj?

Këshillë: Nuk është e nevojshme që përgjigjia të përmbajë gjithë informacionin e materialit përgatitor mbi çështjen. Ajo duhet të përmbajë argumente sa më të sakta dhe të lexohet në mënyrë sa më të qartë.

Shembull: Sa zgjat qëndrimi në detyrë i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë?

Këshillë: Nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen është më mirë të jepni përgjigjen "nuk e di", pasi kështu nuk do të penalizoheni me -1 pikë.

3. **Pyetjet quiz** janë katër për çdo ekip. Përgjigjja e tyre është e shkurtër dhe duhet dhënë në harkun kohor të pesë sekondave. Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me tre pikë dhe çdo e gabuar me minus tre pikë. Në rast se përgjigjja është "nuk e di" skuadra vlerësohet me zero pikë. Vlerësimi maksimal është dymbëdhjetë pikë. Ai bëhet i ditur nga drejtuesi i konkursit dhe regjistrohet nga sekretaria.

Shembull: Cili nga të mëposhtmit është funksion i Bankës së Shqipërisë:

- A. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare;
- B. Emetimi i kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare;
- C. Licencimi dhe mbikëqyrja e aktivitetit të bankave tregtare;
- D. Të gjitha?

Këshillë: Nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen është më mirë të jepni përgjigjen "nuk e di", pasi kështu nuk do të penalizoheni me -3 pikë.

4. **Pyetjet me plotësim termash** janë dy për çdo ekip. Përgjigjja mbi termat që mungojnë jepet me shkrim. Koha në dispozicion për t'u përgjigjur është tre minuta, pas të cilave ajo i dorëzohet drejtuesit. Pas shqyrtimit të tyre, juria jep rezultatet dhe sekretaria i vlerëson ato. Në varësi të saktësisë së përgjigjes vlerësimi varion në intervalin 0-12 pikë.

5. **Zgjidhja e një ushtrimi** i cili është i përbashkët për të gjitha skuadrat, ka të bëjë me zgjidhjen e dy kërkesave të tij. Në harkun kohor të dhjetë minutave konkurrentët duhet të dorëzojnë pranë drejtuesit vlerat e kërkuara në ushtrim dhe një argument për pyetjen “grackë”. Vlerësimi bëhet nga ana e jurisë dhe në varësi me saktësinë e përgjigjes varion në intervalin 0-20 pikë.

Shembull: Letrat me vlerë janë instrumente financiare të cilat mishërojnë të drejta _____ apo njohje _____.

Këshillë: Secila skuadër duhet të shkruajë në mënyrë lehtësisht të kuptueshme. Përpiquni të vendosni termin e saktë dhe jo ta shprehni atë me fjalët tuaja. Shikoni mirë fjalorin “101 Terma bankarë”.

Shembull: Në tabelën e mëposhtme jepet indeksi i përgjithshëm i çmimeve të konsumit, si dhe indeksat e disa grupeve përbërëse të shportës së konsumit.....

- a) Llogarisni normën mujore të inflacionit të çmimeve në total, në muajin dhjetor 2006. Sikur çmimet të rriteshin çdo muaj me të njëjtin ritëm (sa rezultati juaj), sa do të ishte inflacioni total pas 12 muajsh? Llogarisni normën vjetore të inflacionit total në muajin dhjetor 2007, duke përdorur të dhënat në tabelë.

Periudha	Total	Ushqime dhe pije joalkolike	Veshje	Transport	Arsim	Hotel. Kafë. Restorant
Dhjetor 05	109.5	105.6	86.6	111.1	140.3	114.9
Janar 06	109.7	105.6	86.3	111.0	140.4	114.9
Shkurt 06	110.2	106.7	85.3	110.7	140.3	114.9

Këshillë: Bëni kujdes që gjatë përgatitjes për këtë pyetje të mos mjaftoheni vetëm me mësimin e formulave. Kuptimi i koncepteve, si për shembull, ai i inflacionit apo i treguesve të tjerë realë është shumë i rëndësishëm.

6. **Interpretimi i një grafiku** është një pyetje e njëjtë për të gjitha skuadrat. Secilit ekip i vihet në dispozicion një grafik, rreth të cilit ai duhet të bëjë interpretimet e rastiit. Përgjigjet jepen me shkrim brenda kohës së përgatitjes, e cila është pesë minuta. Pas vlerësimit të jurisë përgjigjet ruhen pranë sekretarisë. Në varësi me saktësinë e përgjigjes ai varion në intervalin 0-15 pikë. Nuk lejohet që konkurrentët të ndryshojnë përgjigjen e shkruar gjatë leximit të saj.

7. **Pyetja e ndërsjellë** është pyetja që çdo ekip i drejton ekipit që është ulur në krahun e majtë të tij. Skuadrat duhet ta dorëzojnë pyetjen pranë Sekretarisë së konkursit, një ditë përpara zhvillimit të tij. Ajo shqyrtohet nga Juria, me qëllim që të jetë në përputhje me materialin përgatitor. Koha në dispozicion për t'u përgjigjur është dhjetë minuta.

Shembull: Si ndikon norma e interesit në kursin e këmbimit dhe indirekt në inflacion?

Këshillë: Disa nga skuadrat pjesëmarrëse në konkursin e parë patën vështirësi në kuptimin e thelbit të pyetjes. Mos hezitoni të kërkonin ndihmën e panelit të jurisë, për çfarëdolloj paqartësie mbi pyetjen.

Vetëm në finale

8. **Prezantimi i temës** është një ushtrim, i cili jepet vetëm gjatë fazës finale. Ndryshe nga fazat eliminatorë, në atë finale, organizatorët menduan ta vinin secilën skuadër në rolin e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Për këtë qëllim, ata duhet të marrin një vendim mbi normën nominale të interesit në një rrethanë ekonomike imagjinare.

Kyushtrim ka për qëllim të demonstrojë një situatë ku skuadrat "luajnë" rolin e vendimmarrësve të një banke qendrore (skuadrat janë të lira të fantazojnë një emër për bankën të cilën përfaqësojnë). Si të tillë, ata duhet të marrin një vendim lidhur me politikën monetare që do të ndjekë banka qendrore, pasi të kenë vlerësuar zhvillimet e fundit në ekonominë e vendit dhe parashikimet e specialistëve të bankës për ecurinë e ekonomisë.

Këshillë: Për të qenë sa më të suksesshëm nuk mjafton që të merrni vendimin e duhur. Për të qenë sa më bindës duhet të sillni argumente dhe për më tepër, ato duhet t'i paraqisni bukur. Pra, edhe mënyra e prezantimit ju bën bindës ose e anasjellta ju bën jo të besueshëm.



NË VEND TË MBYLLJES...

Kjo ishte në pak fjalë historia e thjeshtë e një ngjarjeje të bukur, nga e cila përveç të tjerash, lindi edhe një miqësi. Keni dëgjuar të flitet për miqësi të të rinjve me muzikën, sportin, modën, kjo e kësaj rradhe ishte ndryshe. Ishte miqësia e re e të rinjve me bankën qendrore.

Sepse më shumë se pjesëmarrës në një konkurs, ata ishin protagonistë të një ngjarjeje të bukur në jetën e tyre, por edhe në tonën. Ata na shkruajnë për këtë, na pyesin për aktivitete të ardhme...ne nga ana jonë, kemi menduar e hedhur në letër të tjera forma edukimi argëtuese, dedikuar rinisë.

Thoni tani që kjo nuk është një miqësi e re dhe e bukur...për të cilën ne jemi të sigurtë që do të vazhdojë gjatë.



A handwritten signature in black ink, written in a cursive style. The signature is difficult to read but appears to be a name starting with 'A' and ending with 'o'.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në
formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara
të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej"
Nr.1 Tiranë, Shqipëri,

Tel.: +355-(0)4-2222152;

Faks: +355-(0)4-2223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 4000 kopje